

TË ZBULOSH DIÇKA APO TË MERRESH ME ZANAT

Zeni BALLAZHI

Galeria Kombëtare e Kosovës

zeniballazhi@gmail.com

UDC 75.036(497.115)

Review

Përmbledhje

Një fragment nga kati më i ri i arteve pamore të viteve të fundit që po zhvillohen tek shqiptarët në përgjithësi. Mendoj që sot edhe tek ne është bërë një zgjidhje, dhe jemi të bindur se arti nuk është një çështje shijeje të përgjithshme, por një çështje zgjidhjeje personale. Zgjidhja kërkon kurajo dhe vendosmëri, ndërsa shija mbetet përherë e papërcaktuar dhe e pavendosur.

Arti që flet në këtë nivel është një instrument që ndërgjegjëson për bashkëshoqërimet historike, që bën të ngjasin plot gjera, që ngre emocione që kërkon vlerësim, arti i cili nuk i drejtohet ndërgjegjes së transfiguruar metafizike, por heton në kushtet e ekzistencës tokësore dhe prandaj na provokon që t'i shohim gjërat në një mënyrë të re. Në vend të hetimi të kotë të estetikës së gjërave edhe në artin pamor ka filluar përpjekja për zbulimin e një bukurie të fshehur, kërkimi i thelbit (esencës).

Në shumë vepra të arteve pamore, materialet po fitojnë një intensitet të ri, po shpërbëhen në pika të reja ndjesore referimi ku: “Arti kërkon sytë, intelektin, dëshirat, por ai është gjithnjë i lidhur me trupin”. Për natyrë arti është subversiv, ai vë në pikëpyetje realitete të konsoliduara shqetëson tradita të rrënjosura dhe kështu krijon rregulla të reja gjuhësore, njëkohësisht artistike dhe shoqërore.

Fjalët kyçe: *Arti, zbulimin, intensitet, realitete, referimi.*

Të bluash tokë (gurë) dhe të pikturosh me ngjyra dheu duke treguar një realitet, një dramë të thellë, nuk është lehtë, aty vërehet një evoluim teknik dhe unik, një sofistikim i mjeteve shprehëse dhe një orvatje për filozofim. Për të kapur sadopak intenerarin e lëvizjes hapësinore që ngjizë informacionin e veprave të Adem Kastratit, do të ishte mjaft e vështirë



për ne që të gjenim të njejtin mjet transporti, për të ndjerë qoftë dhe përciptas, tërë rrugën e bërë më parë nga ky artist, në formimin e imazhit të tij, mjaft të dallueshëm dhe origjinal.

Adem Kastrati, Darka, 1974, ngjyra dheu mbi pëlhurë, 67 x 70 cm

Vepra „Darka“ e vitit 1974 me ngjyra dheu mbi pëlhurë në një enterier tipik tradicional i jep pikturës një karakter të theksuar autokton me një domethënie të caktuar tepër simbolike. „Buk kripë e zemër“, njëri nga ritualet e ngrohta shqipëtare është zakoni i mikëpritjes që të ofrojë bukë e kripë për çdo mysafir të admiruar, e cila si një akt në vetvete i referohet filantropisë si diçka e përgjithshme edhe tradicionale.

Në këtë tablo zënë vend objekte tradicionale: oxhaku, sofa, shkambi, çerepi, manxha etj, që i japin pikturës një simbolikë me karakter të theksuar origjinal. Motive autoktone të lidhura me fshatin dhe vendlindjen shpalos momente të mbushura me çështje ekzistenciale. Në veçanti trajtoi fshataren, këtë qenie, sipas tij „të drejtpërdrejtë“, që i jep kuptim jetës e që

për piktorin ishte gjithmonë e njëjtë si kur lëviz, si kur punon, si kur dëfrehet, si kur këndon ninulla për fëmijën e saj në djep.

Gratë i paraqet me tipare karakteristike me sy të mëdhenj e me plot rrëfim e ëndërra brenda tyre, që janë pasqyra të shpirtit dhe dritare që shpalojnë botën e figurave, momentet e thella, gjendjet psikike, tmerret e kohërave të paekuilibruara. Burrat ndërkaq duken të rëndë sepse këtë e kanë traditë, ata janë të rëndë edhe kur ecin, edhe kur ulen këmbëkryq, edhe kur punojnë, edhe kur vallëzojnë...ata kanë të rëndë edhe bukurinë fizike.

Fëmijët që shpesh janë prezent në tablotë e tij, fëmijët zgjasin kokat kurioze nga sofa dhe nga prehërit e ngrohtë të nënave dhe gjysheve, fëmijët janë të dashurit e autorit, janë pamje rrëqethëse të fëmijërisë së hershme që lidheshin me golgotën e karvaneve të pafund të bashkëvendasve të tij të shkukur me dhunë nga vatra e të parëve, ishte vetëm një kujtim i hidhur që s'mund të përsëritej kurrë.

Situatat e ambientit rrethues përbëjnë një tablo, e cila identifikohet me njerëzit dhe natyrën e fshatit të vet. Ambienti i mirënjohur dhe shumë herë i përjetuar fiton një kuptim tjetër, që tejkalon atë që është vetëm identike me realitetin, sepse interponohet aspekti i rishikimit të transponimit figurativ. Risi tjetër e kësaj tabloje është përdorimi i vijave të grryera në sipërfaqen e përpunuar të dheut e ngjitur në telajo, bashkë me sytë e figurave të pikturuar me kujdesin maksimal, si elemente qenësore dhe karakteristike të këtyre imazheve, vijat e para të grryera që më pas nuk mund të përmirsohen.

Kjo mënyrë autentike e shprehjes së botës së brendshme përbën njërin nga shtyllat e suksesit të pikturës së tij të pakategorizueshme që nuk shembëllen me rrymat dhe rrugët e panumërta artistike dhe që vetëm në shikim të parë del e ngjashme me pikturën e ashtuquajtur naive. Njëri prej artistëve më të veçantë sa i përket teknikës. Ai nuk i ndryshoi pikëpamjet e veta artistike e pikturale. Ai vazhdoi në të njëjtën udhë deri në fund të jetës së tij.

Mesazhi i Kastratit, para se të ishte fetar apo metaforik, ishte një mesazh human, ku qenë ngjizur dashuria, besimi, lindja, vdekja, pra vetë jeta e njeriut. Kishte për qëllim të pikturonte atë që natyra do të krijonte ndonjëherë jo në këto kushte. Kërkonte të shijonte e të përjetonte botën e ngjyrës, ashtu si ai e përpunonte. Në vepra janë të pasqyruara edhe disa aspekte të jetës së tij individuale nga njëra anë dhe vetë madhështia e këtyre veprave.

Mesazhi i fuqishëm dhe forca befasuese nga ana tjetër që të intrigojnë dhe të nxisin për t'ia bërë të njohur edhe publikut shqiptar këtë figurë të Artit Figurativ. Janë të magjishme sot edhe tablotë tjera me nuancat e dheut, piktura këto të mrekullueshme dhe me një metaforë të fuqishme të një realiteti të jetuar. Me Adem Kastratin, metafora shënoi hyrjen triumfale në pikturën “naive” pa vetëdije. Tek figurat e tij, vërehen disproporcione anatomike (groteske,

karikaturale) por, jo aq të theksuara në krahasim me piktorët naivë që i bëjnë pa vetëdije, spontanisht.

Kastrati i shpreh me qëllim dhe në mënyra fare të vetëdijshme, ku ai me anë të këtyre disproporcioneve anatomike, synon të fiksojë fuqinë e figurës. Në pikturat e tij, karakteristika të veçanta janë edhe: etydet e ndryshme për vdekjen, dasmat, koncertet në oda, ninanullat e lindjeve, vajtimet e vdekjes, dashuria e nënës ndaj fëmijës, lojën e fëmijëve dhe nostalgjia për lojrat e humbura, ishin frute të kërkimit të një forme të re, figura të vogla në një peisazh të madh dhe figura të mëdha në hapësirë të vogël, të tjera raporte krijoheshin mes figurave njerëzore dhe peizazhit, dekorit fshatarak apo qytetar.

Pra, që në fillim ai e shpalosi individualitetin e një artisti tipik shqiptar. Sa i përket figurës së gruas, ai shprehej: *“Gruaja, në përfytyrimin tim është një qenie që i ka duart e zëna me diçka vazhdimisht, prandaj ky angazhim i saj herë-herë mbinjerëzor, bën që në pikturën time, ajo të gjejë një shprehje më të madhe”*, që lë të mendosh që gruaja, është e gjitha e pushtuar prej jetës shtëpiake tradicionale. Kryesorja është motivi i tyre i veçantë tradicional-shqiptar, e deri tek veshja e mrekullueshme popullore.

Legjendat dhe nuset, janë disa nga ciklet e pikturave të punuara me dherëra të marra nga toka shqiptare të pluhurosura me ngjyra mbi pëlhurë. Adem Kastrati ishte i vetëdijshëm në imazhet e tij, por instikti, forca estetike që drejtoi ai, ishte e disiplinuar në respektin e tij, pa kompromis për cilësitë e ngjyrave të marra nga dheu dhe teknika e rafinuar me të cilën ai punoi. Artisti ka vendosur megjithatë një shkallë të lartë të rëndësishme për detaje të vogla.

“Unë jam natyra”, thonë një pjesë e artistve të skenës së artit pamor, duke dhënë shpjegimin më të mirë për veprat e tyre të cilët edhe sot reagojnë në mënyrë ikonoklasike ndaj këtij realiteti që e jetojmë me intensitet. Sidoqoftë, sipas mendimit tim, ndjehet në këtë shprehje një lloj egzorcizmi lidhur me frikën dhe pasigurinë e artistit në lidhje me momentin e krijimit, me intensitetin e emocioneve dhe pamundësinë për të shprehur në fjalë këtë moment, kjo frazë është vazhdimi i një vargu të gjatë qëndrimesh nga ana e artistëve që e shohin veprën e artit si një produkt natyral.

Natyra vazhdon procesin e krijimit nëpërmjet artistit dhe, ashtu siç pranojmë çdo krijim natyral sado të çuditshëm, po ashtu duhet të pranojmë çdo krijim artistik sado të çuditshëm pa pyetur si e pse të tepërta. Është kjo frazë e shumë artistëve si një pohim më i prerë i natyralitetit të veprës së artit që Pikasso e shpreh kështu: *“Çdo njeri do që të kuptojë veprën e artit; pse nuk përpiqen të kuptojnë këngën e një zogu ?”*

Që modernizmi evropian që ndikoi shumë me artin e Ballkanit dhe për pasojë, në artin tonë, kjo lidhet edhe me Luftën e dytë Botërore e cila detyroi eksponentët më të fuqishëm të

modernizmit european të kalonin Europën Juglindore. Kështu ambienti i vakët artistik shqiptarë, papritur u ndodh i rrethuar nga shembuj më avangardistë të artit botëror.

Disa artistë shqiptarë dhe shumë të tjerë, shkuan në Europë dhe prandaj nuk është e çuditshme që poetika surrealistë dhe e modernistëve të tjerë të ndikojë artin e artistëve më të ndjeshëm shqiptarë. Përvoja sociale dhe profesionale thotë se çdo gjë ndodh për një arsye.